



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2018:009725
Datë: 02.09.2021
Numri i dokumentit: 02138137

PA1.nr.1001/2021

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti i përgjithshëm, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Ferit Osmani, kryetar i kolegjit, Hashim Çollaku dhe Beqir Kalludra, anëtarë, me sekretaren juridike, Fitnete Hoti, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit A.S., nga fshati ..., Komuna e Deçanit, për shkak të veprës penale lëndimi i rëndë trupor, nga neni 189 par.5 lidhur me par.1 nën par.1.13 lidhur me nenin 31 të KPK, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Pejë, si dhe ankesës së përfaqësuesit të autorizuar së të dëmtuarit A.K., av.E.M., të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, P.nr.219/2018, të datës 10.06.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 02.09.2021 mori këtë:

AKTGJYKIM

Refuzohen si të pabazuara ankesa e Prokurorisë Themelore në Pejë, si dhe ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të dëmtuarit A.K., av.E.M., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, P.nr.219/2018, të datës 10.06.2021, **vërtetohet.**

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, P.nr.219/2018, të datës 10.06.2021, është shpallur fajtor i akuzuari A.S., për shkak të veprës penale lëndim i rëndë trupor nga neni 189 par.5 lidhur me par.1 nën par.1.13 lidhur me nenin 31 të KPK, dhe i është shqiptuar dënimi me burg në kohëzgjatje prej 6(gjashtë)muajve, i cili dënim do të ekzekutohet ashtu që aktgjykimi të merr formën e prerë. Në dënimin e shqiptuar i llogaritet edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak prej dt.05.10.2017, gjerë me dt.21.10.2017.

Dënimi i mbetur prej 5(pesë)muajve e 14(katërmëdhjetë) ditë burgim, me pëlqimin e të akuzuarit i zëvendësohet në dënimin me gjobë më shumë prej 1.000(njëmijë)Euro, të cilin dënim është obliguar i akuzuari që të paguaj në afat prej 3(tre) muajve pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

Është obliguar i akuzuari që të paguajë shpenzimet e procedurës penale sado që të jenë ato sipas llogarisë së bërë në arkë të gjykatës, paushallin gjyqësor në shumën prej 30 Euro, si dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 30 Euro, në afat prej 15 ditëve, të gjitha këto pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin ligjor ankesë kanë ushtruar:

- Prokuroria Themelore në Pejë, për shkak të vendimit për dënimin, dhe ka propozuar që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të anulohet, kurse çështja penale ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim e vendosje, si dhe

-përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarit A.K., av.E.M., për shkak të vendimit për dënimin dhe ka propozuar që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të ndryshohet përkitazi me vendin për dënimin dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënim më i rëndë, me të cilin dënim do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë, me parashtresën PPA/II.nr.1017/2021, të datës 18.08.2021, duke u sqaruar përkitazi me ankesat e ushtruara, aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, si dhe shkresat e tjera të lëndës, ka propozuar që ankesat të aprovohen si të bazuara, kurse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të ndryshohet përkitazi me vendimin për dënimin dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënimi me i ashpër.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenit 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesat e ushtruara, aktgjykimin e ankimuar, shkresat e tjera të lëndës, si dhe propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, ka gjetur se:

Ankesa e Prokurorisë Themelore në Pejë, si dhe e përfaqësuesit të autorizuar së të dëmtuarit A.K., av.E.M., nuk janë të bazuara

Meqenëse aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë, nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, gjykata duke vepruar në pajtim me nenin 394 të KPPK, e shqyrtoj aktvendimin e ankimuar nëse i njëjti është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, dhe gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit, të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij, për të cilat kjo gjykatë kujdeset kryesisht sipas detyrës zyrtare.

Sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Pejë, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar për shkak të vendimit për dënimin, duke theksuar se në këtë çështje penale gjykata e shkallës së parë nuk i ka vlerësuar në mënyrë të drejtë të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në marrjen e vendimit për dënimin, por si rrethana lehtësuese ka mbi vlerësuar praninë fajësisë nga ana e të akuzuarit, pendueshmërinë e tij, sjelljen korrekte, shprehjen e keqardhjes, si dhe padënueshmërinë e tij më parë për ndonjë vepër tjetër penale, kurse rrethana renduese në këtë çështje penale nuk gjeti, ashtu që të akuzuarit i ka shqiptuar dënim sikurse në dispozitiv të aktgjykimit. Gjykata e shkallës së parë, nuk ka vlerësuar në mënyrë të drejtë natyrën e lëndimeve të pësura të dëmtuarit A.K., të cilat lëndime janë të përshkruara si dëmtime të karakterit të përhershëm, andaj me dënimin e shqiptuar nuk mund të arrihet efekti dhe qëllim i tij, i paraparë me ligj.

Po ashtu ankesë ka ushtruar edhe përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarit A.K., av.E.M., për shkak të vendimit për dënimin, duke theksuar se për këtë lloj dënimi nuk pritet të arrihet qëllimi

i tij, kurse gjykata e shkallës së parë, ka vlerësuar rrethanat lehtësuese sikurse janë pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, pendimi për veprën e kryer penale, qëndrimi korrekt në gjykatë, se i akuzuari është mbajtës i vetëm i familjes pesë anëtarsh, se ka shpreh keqardhje për veprën e kryer penale, dhe ka theksuar se ndihet i turpëruar dhe i kërkon falje të dëmtuarit dhe të gjithëve prezent në gjykatë, duke shpreh gatishmëri që ti përgjigjet të dëmtuarit në çdo formë që kërkohet, andaj gjykata e shkallës së parë, ka vlerësuar këto rrethana, kurse nuk e ka vlerësuar mënyrën e kryerjes së veprës penale, si dhe shprehjen e këmbëngulësisë dhe të vrazhdësisë së të akuzuarit, që ta kryejë veprën penale të cilat janë si rrethana rënduese, dhe me vlerësimin e lëndimeve trupore të pësuar, të cilat janë të përshkruara më për së afërmi me fletë lëshimin dhe ekspertizën e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, Klinika e Neurokirurgjisë, lëndimet e pësuar janë të përshkuara, andaj jemi të bindur se të akuzuarit do ti shqiptohet një dënim më i ashpër, për çka i propozojmë edhe kolegjit të kësaj gjykate të ketë parasysh ankesën dhe ta ndryshon vendimin për dënimin.

Kolegji i kësaj gjykate, e ka vlerësuar aktgjykimin e ankimuar, ankesat e ushtruara, sikurse janë ankesa e prokurorisë, si dhe përfaqësuar të autorizuar të dëmtuarit A.K., av. Esad Muharemi, dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim se i njëjti nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkeljet e ligjit penal, se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë dhe të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike, e cila është vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, për veprën penale e cila i vihet në barrë, si dhe nga provat e tjera nga shkresat e lëndës. Gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së vendimit për dënimin, caktimit të llojit dhe lartësisë së tij, ka vlerësuar të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 të KPK, dhe se rrethanë lehtësuese ka vlerësuar faktin se i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, se ka shprehur keqardhje për veprën e kryer penale dhe është penduar për të njëjtën, se është familjar - i martuar – baba i pesë fëmijëve, se publikisht ka kërkuar falje nga ana e të dëmtuarit dhe ka theksuar se e ndien veten të turpëruar për veprën e kryer penale, kurse si rrethanë rënduese ka pasur parasysh mënyrën e kryerjes së veprës penale, si dhe shkallën e intensitetit të kryerjes së të njëjtës. Nga ankesa e prokurorisë si dhe nga ankesa e përfaqësuesit të autorizuar së të dëmtuarit, nuk ka gjetur ndonjë rrethanë posaçërisht rënduese, andaj në prani të këtyre rrethanave, kolegji është i bindur se me dënimin e shqiptuar do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij, që të parandalojë kryerësit nga kryerja le veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, të paraparë në nenin 38 të KPK-së.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1.nr.1001/2021, të datës 02.09.2021

Sekretarja juridike,
Fitnete Hoti

Anëtarët e kolegjit
Hashim Çollaku

Kryetari i kolegjit
Ferit Osmani

Beqir Kalludra